



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 80, datë 26.07.2017

PËR

“ KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR RISHIKIMIN E EMËRTIMEVE TË PJESËVE TË TERRITORIT PUBLIK (BULEVARD RRUGE, RRUGICE SHESH, PARK) DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ”.

Në mbështetje të nenit 3 shkronja (ç), nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronjat (b) dhe (d), nenit 54, shkronja (ç) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 5, shkronja (ç) të ligjit 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”; vendimit nr. 84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I

1. Të miratojë ngritjen e Komisionit “Për rishikimin e emërtimeve të pjesëve të territorit publik (bulevard, rruge, rrugice shesh, park) brenda territorit të Bashkisë Tiranë.
2. Komisioni vepron si organ Këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe përbëhet nga 15 anëtar, si më poshtë:
 - Prof. Nevila Nika;
 - Prof. Shaban Sinani;
 - Prof. Mariglen Kasmi;
 - Prof. Fatmira Rama;
 - Prof. Afrim Krasniqi;
 - Prof. Pëllumb Xhufi;
 - Prof. Paskal Milo;
 - Prof. Klodeta Dibra;
 - Prof. Shezai Rrokaj;
 - Prof. Mirela Bogdani;
 - Studiues (historian), Artan Lame;
 - Arkitekt, Artan Shkreli;
 - Prof. Ismail Demneri.
 - Aldrin Dalipi;
 - Abaz Hado.

3. Komisioni Këshillimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij për një afat kohor 1 vjeçar (shtator 2017-shtator 2018). Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të komisionit, Këshilli Bashkiak mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.
4. Komisioni zgjedh me shumicë votash kryetarin dhe sekretarin e komisionit, të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e tij.
5. Komisioni organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e Rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit Këshillimor “Për rishikimin e emërtimeve të rrugëve brenda territorit të Bashkisë Tiranë”, e cila miratohet që në mbledhjen e parë të tij.
6. Pagesa për anëtarët është 5 000 (pesëmijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit.
7. Komisioni Këshillimor nuk mund të mbledhet më shumë se një herë në muaj.
8. Efektet financiare të pikës 6 të këtij vendimi do të përballohen nga aparati i Bashkisë, në programin e administratës vendore, artikulli 602 të parashikuara në buxhetin e vitit 2017.
9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për krijimin e kushteve të punës, mbështetjen financiare e logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni.
10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI